VENDIM
Nr. 753, datë 19.12.2018

PËR MIRATIMIN E LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE NR. 2 TË MARRËVESHJES SË GRANTIT NR. TF0A1769, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE TË GRANTIT TË AKORDUAR NGA FONDI I MIRËBESIMIT ME SHUMË DONATORË, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË ZBATIMIT TË NISMËS PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRINË NXJERRËSE NË SHQIPËRI (EITI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes ndryshuese nr. 2 të marrëveshjes së grantit nr. TF0A1769, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të akorduara nga Fondi i Mirëbesimit me Shumë Donatorë, për financimin e projektit të zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri (EITI), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

BANKA BOTËRORE
IBRD.IDA/GRUP I BANKËS BOTËRORE

22 maj 2018

Sh.t. z. Arben Ahmetaj
Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi Dëshmorët e Kombit, nr. 3
Tiranë
Republika e Shqipërisë

Lënda: Granti EGPS për Zbatimin e Financimit të Projektit të Zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse

(Marrëveshja e Grantit nr. TF0A1769 dhe TF0A6493)
Amendimi nr. 2 i Letër Marrëveshjes

Shkëlqesi:

Ne i referohemi Letër Marrëveshjes ("Marrëveshja") së datës 26 shkurt 2016, të ndryshuar, për zbatimin e Financimit të Projektit të Zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse ("Projekti") ndërmjet Republikës së Shqipërisë ("Marrësi") dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka Botërore"), sipas të cilës Banka Botërore ka zgjeruar Grantin e sipërpërmendur ("Granti").

Banka Botërore propozon ta amendojë Marrëveshjen si vijon:

1. Paragrafi i parë i Marrëveshjes në këtë mënyrë amendohet dhe ndryshohet në tërësi me tekstin e mëposhtëm:

"Në përgjigje të kërkesës për asistencë financiare të bërë në emër të Republikës së Shqipërisë ("Marrësi"), kam kënaqësinë t'iu informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka Botërore"), në

cilësinë e administratorit të fondeve të grantit të dhënë nga Federata e Australisë, Kanadaja, Republika e Finlandës, Republika Federale e Gjermanisë, Mbretëria e Norvegjisë, Zvicra dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës ë Veriut ("Donatorët"), në bazë të Mbështetjes Programatike Globale për Industritë Nxjerrëse (EGPS) Fondi i Besimit me Shumë Donatorë, propozon t'i japë Marrësit një grant në shumën që nuk tejkalon një milion dollarë amerikanë (1,000,000 dollarë amerikanë) (Granti) që përbëhet nga: a) katërqind mijë dollarë amerikanë (400,000 $) (TF0A1769-granti fillestar); dhe b) gjashtëqind mijë USD (600,000 $) (TF06493-granti shtesë) sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose të përmendura në këtë Letër Marrëveshjeje ("Marrëveshja"), e cila përfshin shtojcën bashkëlidhur, për të asistuar me financimin e Projektit të përshkruar në shtojcë (Projekti)".

2. Seksioni 2.08 i shtojcës së Marrëveshjes me këtë ndryshohet dhe amendohet në tërësi me tekstin e mëposhtëm:

"2.08. Prokurimi

Të gjitha mallrat dhe shërbimet e konsulencës së kërkuara për Projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e Grantit do të prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të referuara në "Rregulloren e Bankës Botërore për Huamarrësit e IPF-së", të muajit korrik 2016, të rishikuar në nëntor 2017 ("Rregulloret e Prokurimit") dhe sipas parashikimeve të Marrësit për Planin e Prokurimit të Projektit ("Plani i Prokurimit") të datës 30 prill 2018, të parashikuar sipas seksioni IV të Rregulloreve të Prokurimit, i cili mund të përditësohet herë pas herë në marrëveshje me Bankën Botërore."

3. Tabela nën seksionin 3.01 të aneksit të Marrëveshjes është amenduar dhe zëvendësuar në tërësinë e saj me tekstin e mëposhtëm:

"Kategoria"	**TF0A1769 Shuma e alokuar e (e shprehur në dollarë amerikanë)**	**Përqindja e Shpenzimeve për t'u financuar (duke përfshirë taksat)**	**TF0A6493 Shuma e alokuar e grantit (e shprehur në dollarë amerikanë)**	**Përqindja e shpenzimeve për t'u financuar (duke përfshirë taksat)**
Mallra, shërbime konsulence, trajnime dhe kosto operative të projektit	400,000	100 %	600,000	100%
SHUMA TOTALE	**400,000**		**600,000**	

Të gjitha termat dhe kushtet e tjera të Marrëveshjes, përveç atyre të amenduara nëpërmjet kësaj letre amendimi, do të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

Ju lutem, konfirmoni Marrëveshjen e Marrësit me Amendimin e mësipërm, duke nënshkruar, duke vënë datën dhe duke e kthyer tek në kopjen bashkëngjitur të kësaj letre amendimi. Kjo letër amendimi do të hyjë në fuqi nga data në të cilën Banka Botërore dërgon te Marrësi njoftimin për marrjen e njoftimit të Marrësit mbi mbylljen e procedurave të brendshme, të nevojshme për hyrjen e tij në fuqi sipas legjislacionit të Marrësit.

Me respekt,

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim e Zhvillim
Maryam Salim
Menaxhere vendi
Zyra e Bankës Botërore
Republika e Shqipërisë

MIRATUAR:

Republika e Shqipërisë
Nga: _____ Data: 15.11.2018
Përfaqësuesi i Autorizuar
Emri: **Arben Ahmetaj**
Pozicioni: Ministër i Financave dhe Ekonomisë